



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 1649 Dt. 14 / 09 / 2023

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2., të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e XLVI të mbajtur më datë 07.09.2023, mori këtë:

VENDIM

Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku rizgjidhet në thirrjen akademike **Profesor i Asociuar** nga fusha kompjuterike në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike për lëndët : (Programi Bachelor: Programimi I (O); Programimi II (O); Algoritmet/Strukturat e të dhënave (O); Aplikimi i Aproximimeve në A I dhe Robotikë (O) dhe Programi Master: Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificialet). në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Rizgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 168, 169 dhe 171 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/742 të datës 28.04.2022.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Ligjin për pagat në sektorin publik Ligji Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs Ref.nr.01/856 të dt.28.04.2023, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik një mësimdhënës në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike për lëndët: (Programi Bachelor: Programimi I (O); Programimi II (O); Algoritmet/Strukturat e të dhënave (O); Aplikimi i Aproximimeve në A I dhe Robotikë (O) dhe Programi Master: Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificialet).

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, i plotëson kushtet për t'u rizgjedh në thirrjen akademike Profesor i Asociuar për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve sipas raportit Ref.nr. 05/1428 të datës 27.07.2023, vendosi që Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku të rizgjidhet në thirrjen akademike Profesor i Asociuar.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:



Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor
Kryesues i Senatit